



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 07.04.2022 Nr. 020-314
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim Nr. 01-463/01-0019242/22 i datës 31.03.2022 i Kuvendit të Komunës së Skenderajt	

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 06.04.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr. 01-463/01-0019242/22, për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2022, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

### KONFIRMON

Vendimin Nr. 01-463/01-0019242/22, për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2022, *është në pajtim* me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2022, ka miratuar Vendimin Nr. 01-463/01-0019242/22, për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2022.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në Planin Zhvillimor Komunal, Pëlqimin Mjedisor Nr. 17/1446/1-ZSP/103/17, si dhe në Hartën Zonale. Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Skenderajt me datë 31.03.2022 me 17 vota për, 7 kundër dhe 0 abstenim, për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2022, listë kjo me pronat të cilat kanë të përcaktuar interesin publik.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Fadil Nura, gradonačelnik opštine Srbica Adelina Spahiu, predsedavajuća Skupštine opštine Srbica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS	Datum: 07.04.2022 br. 020-314
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Vjosa Ahmetaj, viša službenica za monitorisanje opština	
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:		
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:		
Predmet:	Razmatranje zakonitosti akta Skupštine opštine	
Vrsta akta:	Odluka 01-463/01-0019242/22, od 31.03.2022.godine, opštine Srbica	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajuća,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenidopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je dana, 06.04.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Odluku br. 01-463/01-0019242/22, o objavljivanju opšteg spiska nepokretne imovine Opštine Srbica koje se planiraju dati na korišćenje fizičkim/pravnim licima za 2022. godinu, usvojenu od strane Skupštine opštine Srbica.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) je razmotrilo zakonitost dotičnog akta, i:

### POTVRĐUJE

Odluku br. 01-463/01-0019242/22, o objavljivanju opšteg spiska nepokretne imovine Opštine Srbica koje se planiraju dati na korišćenje fizičkim/pravnim licima za 2022. godinu, *je u suglasnosti* sa odredbama zakonodavstva na snazi.

### Obrazloženje

Skupština opštine Srbica na sednici održanoj dana, 31.03.2022.godine, usvojila je Odluku br. 01-463/01-0019242/22, o objavljivanju opšteg spiska nepokretne imovine Opštine Srbica koje se planiraju dati na korišćenje fizičkim/pravnim licima za 2022. godinu.

MALS, konstatuje da je usvojena odluka, od strane Skupštine opštine Srbica zasnovana na članu 12 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, na članu 13 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, na članu 6 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razmenu opštinske imovine, u Planu razvoja opština, Saglasnosti životne sredine br.17/1446/1-ZSP/103/17, kao i u Zonskoj karti. Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Srbica dana, 31.03.2022.godine sa 17 glasova za, 7 protiv i 0 uzdržanih, o objavljivanju opšteg spiska nepokretne imovine Opštine Srbica koje se planiraju dati na korišćenje fizičkim/pravnim licima za 2022. godinu, spisak imovine koje utvrđuju javni interes.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.